



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:065289

Datë: 21.04.2022

Numri i dokumentit: 02941831

P.nr. 991/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. I., të cilin, sipas autorizimit e mbron av. Ermira Halimi, për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 nënpar.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas Aktakuzës. PP.II. nr. 1501/2018, të datës 30.10.2018 të Prokurorisë Themelore, Departamenti Përgjithshëm në Gjilan, në bazë të nenit 232 dhe 253, par.1.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), pas mbajtjes së seancës së ndërmjetësimit, më datën 19.04.2022 dhe më datë 21.04.2022, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim e arritur në mes të të akuzuarit A. I. dhe të dëmtuarit S. N., e lidhur në Qendrën në Ndërmjetësimin në Gjilan, më datë 19.04.2022, me numër Nd. 48/2022.

II. HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, me nr. PP.II.nr. 1501/2018, të datës 30.10.2018 dhe Pushohet procedura penale kundër të akuzuarit për shkak se ka arritur marrëveshjen për ndërmjetësim me palën e dëmtuar.

III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjeteet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën me nr. PP.II.nr. 1501/2018, të datës 30.10.2018 kundër të akuzuarve A. e. E. I., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 nënpar.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

Meqë i akuzuari E. I. gjendet jashtë shtetit të Kosovës dhe pa dokumente, gjyqtarja, për hir të ekonomizimit të procedurës penale, e veçoi procedurën ndaj tij dhe e vazhdoi procedurën me të akuzuarin A. I.

Kjo gjykatë, me kërkesën e të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij, av. Ermira Halimi dhe të dëmtuarit e ka dërguar lëndën në Zyren për Ndërmetësim në Gjilan.

Më dt. 19.04.2022 në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjilan, është arritur marrëveshja për zgjidhjen e kësaj çështje penale përmes ndërmjetësimit në mes të të akuzuarit Ardian Isufi dhe të dëmtuarit Sali Nishori.

Qendra për Ndërmjetësim, më dt. 19.04.2021, me Vendimin Nd.-nr. 48/2022, ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Gjykata, duke u bazuar në provat si më lartë, dhe në bazë të nenit 253 par.1 nënpar.1.2 të KPPRK-së, dhe nenit 12 par.12.5 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 991/2018, më 21.04.2021

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar Ankesa. Kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.